

NE SHKOJMË



PËRPARA

DEMOKRACIA NË VENDIN TONË

ANES (13), LEART (13), RINA (13), FLAMUR (13), ALTIN (13)



Ne sot mësuam për rolin tonë dhe sa të rëndësishëm jemi ne në demokraci


Në demokraci ne gëzojmë të drejta dhe liri, sepse demokracia është udhëheqje e popullit. E si mund të udhëheq populli? Populli mund të udhëheq përmes votës, duke marrë pjesë në zgjedhje. Pra roli ynë kur të mbushim moshën 18 vjeçare do të jetë shumë i rëndësishëm. Demokracia rrjedh nga fjala greke „demo“, që do të thotë popull dhe „kratia“, që nënkupton rend ose qeverisje. Demokracia ndahet në dy lloje dhe ato janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë është kur populli merr vendime për shtetin drejtpërdrejtë. Kurse ajo përfaqësuese do të thotë kur populli zgjedh përfaqësuesit e vet. Demokracia për herë të parë lindi në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë, në vitin 507 para erës sonë. Atëherë nuk kishte të drejta të barabarta sepse atje kishin të drejta vetëm të pasurit. Do të thotë vetëm burrat që kishin shumë prona. Po ashtu, demokracia ka disa elemente si: toleranca, solidariteti, paqja, barazia etj.

Gjithashtu, të drejtat duhet t'i kemi të barabarta, pa dallim moshe, race, gjinie, feje apo kombi, etj.

Ne sot në organizatën TOKA, ne kemi mësuar shumë gjëra për demokracinë, në Punëtoritë „Demos-ti“.

Ne gjithashtu sot e kuptuam që kemi një rol të rëndësishëm në demokraci. Prandaj ne formojmë demokracinë edhe më të mirë duke mësuar shumë dhe duke

qenë të sukseshëm e të ditur.



Autorët e artikullit

RËNDËSIA E VOTËS

LORENA (13), ELMEDIN (13), ARLIND (13), ALBINA (14), OGERTA (13)

Zgjedhjet, llojet e zgjedhjeve dhe deputetët si përfaqësues të popullit

Të jesh demokrat do të thotë të jesh i lirë. Demokracia është formë e qeverisjes. Idea kyçe e demokracisë është krijimi i një populli sovran. Ajo ndahet në demokracinë e drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese.

Proceset zgjedhore janë pjesë e demokracisë. Fjala zgjedh i ka dy kuptime, zgjedhje në jetën e përditshme dhe zgjedhje në sistemin demokratik.

Në kohët e mëhershme të drejtën e votës e kishin vetëm burrat e pasur kurse femrat nuk e gëzonin këtë të drejtë, kurse sot femrat e gëzojnë këtë të drejtë dhe marrin pjesë në jetën demokratike. Njerëzit që janë në moshën mbi 18 vjet mund të votojnë për shkak të vetëdijësimit të tyre.

Zgjedhjet ndahen në zgjedhje lokale dhe parlamentare. Zgjedhjet lokale janë kur e zgjedhim kryetarin

e komunës kurse zgjedhjet parlamentare kur zgjedhim deputetët. Njerëzit e zgjedhur që përfaqësojnë popullin quhen deputetë.

Puna e tyre është të nxjerrin ligje ose të diskutojnë rreth tyre. Deputetët pjesën më të madhe të kohës së tyre e kalojnë me qytetarët që t'i zgjedhin problemet e tyre.

Deputetët duhet t'i përmbushin disa kritere: të jenë të besueshëm, të drejtë dhe t'i mbajnë premtimet e dhëna.


Deputetët para zgjedhjeve e mbajnë një fushatë parazgjedhore, të cilët japin premtimet dhe shpalosin programin e tyre se çfarë do të bëjnë për qytetarët. Votimi është shumë i rëndësishëm sepse ne me votën tonë mund të bëjmë ndryshimin e vendit.



Deputeti në fushatën parazgjedhore



Votimi i sotshëm dhe i atëhershëm




Të gjithë të drejta të barabarta



Bashkimi bën fuqinë

FUNKSIONIMI MË I MIRË I SHTETIT



RINOR (13), ALTINA (14), ERONA (13), FATLINDA (13), VESA (13)



Ndarja e pushtetit në Republikën e Kosovës

Shteti funksionon shumë mirë kur pushteti ndahet në tri degë. Kosova si Republikë Demokratike ka tri ndarje të pushtetit të cilat janë: pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe pushteti gjyqësor. Kjo ndarje e pushtetit bëhet në mënyrë që secili pushtet ta kryej detyrën e vet në mënyrë të pavarur dhe shteti të funksionoj më mirë. Në pushtetin legjislativ bën pjesë Kuvendi ku nxirren dhe miratohen ligjet. Në Kuvend merren vendimet më të rëndësishme për jetën tonë, prandaj secili duhet të marrë pjesë në zgjedhje në mënyrë që të zgjedhen deputetët që do të na përfaqësojnë neve në Kuvend. Në pushtetin ekzekutiv bën pjesë Qeveria e cila përbëhet nga Kryeministri, zëvendës ministrat dhe ministrat. Detyra e Qeverisë është që të zbatoj ligjet e marra nga Kuvendi. Përveç Kuvendit të drejtën e paraqitjes së projektligjeve e ka edhe Qeveria. Qeveria

poashtu mundëson zhvillimin ekonomik të vendit dhe i propozon Kuvendit buxhetin e Republikës së Kosovës. Në pushtetin gjyqësor bën pjesë gjykata, roli i së cilës është ta mbajë drejtësinë e vendit. Kemi tri lloje të gjykatave: Gjykata Themelore, Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit. Secili pushtet duhet t'i trajtojë të tjerët në mënyrë të barabartë meqenëse barazia është një prej elementeve themelore të demokracisë.



Të gjithë kemi të drejta të barabarta



Gazetarët e rinjë të demokracisë

QYTETARIA NË DEMOKRACI

BETIMI (13), VLERA (13), ARTA (13), ENEIDA (13), REA (13)

Zogjtë i ndërtojnë foletë në drunjë kurse ne i ndërtojmë të drejtat tona në demokraci

Qytetarë janë të gjithë njerëzit të cilët jetojnë në një shtet. Në demokraci qytetarët janë të barabartë pa dallim race, feje, gjinie etj. Fjala qytetar rrjedh nga gjuha latine „civitas“ që do të thotë qytetarë të bashkuar në një komunitet.

Qytetar i mirë është ai person i cili i përmbush obligimet ndaj shtetit si p.sh. tatimi në pronë, pjesëmarrja në votime, etj. Qytetarët kanë të drejta, detyra dhe përgjegjësi. E drejtë e qytetarit është të jetoj i lirë, të flas lirshëm, të shprehet lirshëm etj. Ndjenja e përgjegjësisë e shoqëron njeriun gjatë tërë jetës.

A jemi të obliguar që ta kryejmë një përgjegjësi? JO, nuk jemi të obliguar ta kryejmë atë përgjegjësi, por e ndjejmë në vete. Ndjenja e përgjegjësisë krijohet në rrethin familjar, shkollor dhe shoqëror. Çdo punëtor në rrethin ku punon ka detyra. Detyrë parësore e çdo punëtori është respektimi i orarit të punës, respektimi ndaj kolegëve, mirëmbajtja e vendit ku punon, respektimi i rregullave etj.


TË DREJTAT E FËMIJËVE

Secili fëmijë posa të lind ka të drejtën e emrit, mbiemrit, kujdesit prindëror, etj.


Fëmijët keqtrajtohen, shiten si robër në shumë vende të botës. Për këtë arsye, janë krijuar shume dokumente për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Njëra ndër dokumentet është Konventa e të Drejtave të Fëmijëve, e cila është themeluar më 20 nëntor 1989. Kjo Konventë është nënshkruar nga 191 shtete.



Bashkimi bën fuqinë




Demokracia jep të drejta, ato lidhen me përgjegjësitë



Ne kemi të drejta dhe përgjegjësi



Betimi është qytetar i ndershëm



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit
SHFMU „Nazim Gafurri“
Klasa: VIII-2
Vendi: Prishtinë